



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1167/3 prot.,

Tiranë, më 20.05.2021

VENDIM

Nr. 36, datë 20.05.2021

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR ADMINISTRATOR TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 51, pika 2 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 26, pika i), të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 4, datë 14.01.2021 “Për shpalljen e konkursit për pozicionin e punës “Administrator i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” dhe miratimin e kriterëve dhe dokumentacionit të punësimit”, të Buletinit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 14, datë 01.02.2021, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 35, datë 16.04.2021 “Për ngritjen e komisionit me qëllim vlerësimin e dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar për administrator të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, të shkresës së Komisionit ad hoc nr. 208/28 prot., datë 17.05.2021 “Mbi vlerësimin e dosjeve të kandidatëve që kanë aplikuar për Administrator pranë UMT-së”, të rendit të ditës, si dhe pas njohjes dhe shqyrtimit të materialit të prezantuar nga Komisioni ad hoc, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për Administrator të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si më poshtë:
 - Besnik Çina
 - Shkëlqim Sallaku
 - Altin Pasko
 - Redi Shtino
 - Erjon Laska
 - Bukurie Tafhasi
 - Robert Skënderi
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
ARBEN GJATA**

